



KUSHTET STANDARDE MINIMALE TE SIGURIMIT NE GRUP TE PUNONJESVE TE MINIERAVE NGA AKSIDENTET PERSONALE NE PUNE

Neni 1. "PËRCAKTIME"

1.1 "Aksident" ose "Aksidental" - një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh në mënyrë rastësore pa vullnetin e të Siguruarit, e identifikueshme përsa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të Siguruarin dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë ose dëmtime trupore të të Siguruarit.

1.2 "Dëmtim Trupor Aksidental" - dëmtim trupor që pëson i Siguruari Brenda periudhës së policës, që shkaktohet vetëm dhe drejtpërdrejt, të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të Siguruarin dhe që sjell si rrjedhojë humbjen e jetës ose paaftësinë për punë të të Siguruarit brenda 12 muajve kalendarikë nga data e Aksidentit.

1.3 "Përfitim" - shuma përkatëse e sigurimit ose pjesë të saj siç përcaktohet në Formularin e Policës dhe Tabelën e Përfitimeve, e pagueshme nga Siguruesi në përputhje me kushtet dhe parashikimet e kësaj Police për çdo ngjarje ose dëmtim që mbulohet nga kjo Policë.

1.4 "Siguruesi" - shoqëria e sigurimeve e autorizuar sipas rregullave në fuqi për sigurimin e klasës së "Aksidenteve Personale".

1.5 "Data e Fillimit" - data në të cilën fillon mbulimi në sigurim sipas kësaj Police.

1.6 "I Siguruar" - individ(ët) e emërtuar si të siguruar në Listën e të Siguruarve ose në ndryshime të mëvonshme të saj, të moshës 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç deri në 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç në datën e fillimit të Policës.

1.7 "Paaftësi e Përhershme e Plotë" - paaftësia që e ndalon plotësisht të Siguruarin për të ushtruar profesione/punësime për të cilat është i aftë nga arsimimi, trajnimi ose përvoja, dhe që zgjat të paktën 12 muaj të pandërprerë dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë përmirësimi.

1.8 "Paaftësi e Përhershme e Pjesëshme" - paaftësia që e ndalon pjesërisht të Siguruarin për të ushtruar profesione/punësime për të cilat është i aftë nga arsimimi, trajnimi ose përvoja, dhe që zgjat të paktën 12 muaj të pandërprerë dhe në fund të kësaj periudhe është pa shpresë përmirësimi.

1.9 "Paaftësi e Përkohshme e Pjesëshme" - nënkupton pamundësinë e përkohshme të Personit të Siguruar për të kryer të pjesë të detyrave të punës së zakonshme profesionale, ndërsa është nën kujdesin e rregullt dhe ndjek instruksionet apo këshillat e mjekut.

1.10 "Paaftësi e Përkohshme e Plotë" - nënkupton pamundësinë e përkohshme të





Personit të Siguruar për të kryer të gjitha detyrat profesionale, ndërsa është nën kujdesin e rregullt dhe ndjek instruksionet dhe këshillat e mjekut.

1.11 "Policëmbajtës/Kontraktues" - punëdhënësi i përcaktuar si Kontraktues në Formularin e Policës.

1.12 "Policë" - këto kushte, Formulari dhe çdo shtojcë ose ndryshim i mëvonshëm i nënshkruar nga Siguruesi.

Neni 2. "PËRFUNDIMI I MBULIMIT NË SIGURIM"

2.1 Përfundimi i mbulimit në sigurim. Mbulimi në sigurim për të Siguruarin do të përfundojë me ndodhjen e më të hershmes prej ngjarjeve të mëposhtme: **a)** Përfundimi i periudhës së Policës, **b)** Data në të cilën i Siguruari përfundon së qeni punonjës i Kontraktuesit, **c)** Kur ka përfunduar ekzekutimi i tabelës së përfitimeve të përcaktuar në policë.

2.2 Përfshirja dhe largimi. Kjo Policë do të mbulojë automatikisht në sigurim të gjithë punonjësit e pranishëm dhe të rinj të Kontraktuesit nga data e fillimit të punësimit, me kusht të njoftimit që i bën Kontraktuesi Siguruesit brenda 10 ditësh nga fillimi i punësimit për çdo punonjës që shtohet. Mbulimi në sigurim përfundon në datën e Përfundimit të punësimit. Në rast kërkesë për dëmshpërblim Kontraktuesi gëzon të drejtën e zëvendësimit të një punonjësi të larguar me një të ri pa prim shtesë, me kushtin e njoftimit brenda 10 ditëve nga data e zëvendësimit.

Neni 3. "PËRFITIMET"

3.1 Mbulimi në sigurim. Nëse gjatë periudhës që kjo Policë është në fuqi i Siguruari pëson Dëmtim Trupor Aksidental në punë me pasojë çdonjërën prej dëmtimeve të përshkruara në Tabelën e Përfitimeve, atëherë Siguruesi, me marrjen dhe miratimin e provave të nevojshme, do të paguajë

shumën përkatëse të përfitimit sipas Tabelës së Përfitimeve.

Neni 4. "PËRJASHTIME "

Siguruesi nuk do të mbulojë humbjen e jetës, paaftësinë për punë apo dëmtime trupore të të Siguruarit që janë rrjedhojë direkte ose indirekte e:

a) Luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes;

b) Reaksionit bërthamor, rrezatimit bërthamor ose ndotjes radioaktive, pavarësisht nga burimi i tyre;

c) Sindromës së Defiçencës Imunitare të Fituar (AIDS) dhe gjendjeve shëndetësore të lidhura me të;

d) Sëmundjeve, kontrolleve, kurimeve apo ndërhyrjeve kirurgjikale që nuk janë rezultat i aksidentit në punë gjatë periudhës së sigurimit;

e) Vetëvrasjes ose tentativës për vetëvrasje ose akteve të kryera me dashje apo të mbetura në tentativë nga i Siguruari dhe/ose përfituesi.

f) Pjesëmarrjes në sporte të rrezikshme si parashutizmi, ngjitjet malore, fluturimi me avionë pa motor, zhytjeve nënujore, garave motorike;

g) Pjesëmarrjes së të Siguruarit në zënka e grindje;

h) Dehjes, përdorimit të tepruar të psikofarmaceutikëve, drogës ose aluçinanteve;

i) Drejtimit të mjeteve motorike tokësore, ujore, ajrore, pa qenë i pajisur me dëshminë përkatëse të aftësisë, apo të qenit pasagjer në mjetet e lartpërmendura të pa licencuara për transport pasagjerësh;

j) Përdorimit të lëndëve eksplozive dhe çorodive, përveç rasteve kur është në përmbushje të detyrës profesionale;

k) Përfshirjes së të Siguruarit në aktivitete të





paligjshme apo kriminale;

l) Çdo lloj defekti fizik apo mendor i të sigurvearit që nuk është shkaktuar nga aksidenti në punë gjatë periudhës së sigurvearit;

m) Mosrespektimi i rregullave të sigurvearit teknike dhe personale në punë;

n) Pakujdesia e rëndë e të sigurvearit;

o) Akte të kryera me dashje apo të tentuara nga i sigurveari apo përfituesi në dëm të të sigurvearit;

p) Ekspozimi i hapur dhe me vetëdije nga ana e të sigurvearit kundrejt rreziqeve.

Neni 5. "PROCEDURA PËR KËRKESA PËR PAGESË"

5.1 Njoftimi i ngjarjes së sigurimit. Çdo ngjarje ose dëmtim që mund të çojë në një kërkesë për pagesë/përfitim sipas kësaj Police duhet t'i njoftohet me shkrim Sigurvearit brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e ndodhjes. Mosnjoftimi brenda periudhës kohore të parashikuar më sipër nuk do ta bëjë të pavlefshme kërkesën për përfitim, nëse provohet se nuk ka qenë mundësuar në mënyrë të arsyeshme. I Sigurveari ose Kontraktuesi, me shpenzimet e tyre, do t'i paraqesin Sigurvearit dokumentacionin, informacionin dhe dëshmitë që mund të kërkojë Sigurveari. Sigurveari do të ketë të drejtë, por jo detyrim, që me shpenzimet e tij t'i kërkojë të Sigurvearit të kryejë kontrolle mjekësore gjatë shqyrtimit të kërkesës për përfitim.

5.2 Pagesa e përfitimit. Sigurveari do ta trajtojë Kontraktuesin/Policëmbajtësin (punëdhënësin) si përfaqësuesin ligjor të kësaj Police dhe çdo shumë e pagueshme sipas kësaj police do të paguhet për llogari të Të Sigurvearit në përputhje me kërkesën dhe udhëzimet e Kontraktuesit dhe pagesa e kryer në këtë mënyrë do ta çlirojë Sigurvearin nga çdo përgjegjësi e mëtejshme për përfitimin në fjalë.

5.3 Nëse kryhen kërkesa për përfitim që janë mashtruese në ndonjë aspekt, ose nëse Kontraktuesi, I Sigurveari apo përfaqësues që veprojnë në emër e për llogari të tyre përdorin mjete ose metoda mashtrimi për të përfituar pagesa sipas kësaj Police, atëherë Sigurveari nuk do të ketë përgjegjësi për pagesën e këtyre kërkesave.

Neni 6. "PARASHIKIMET TË TJERA"

6.1 Kufijtë gjeografikë

Mbulimi i dhënë nga kjo Policë është i vlefshëm brenda kufijve territorialë të Republikës së Shqipërisë.

6.2 Përmbytja e parashikimeve të Policës

Mospërmbytja e parashikimeve të kësaj Police do t'i bëjë të pavlefshme kërkesat për përfitim.

6.3 Pagesa e primeve

Primi i sigurimit paguhet sipas përcaktimeve në formularin e Policës së Sigurimit. Nëse primi nuk paguhet si më sipër atëherë kjo Policë bëhet e pavlefshme dhe mbulimi i dhënë prej saj përfundon prej fillimit.

6.4 Juridiksioni

Çdo kundërshti mbi këtë Policë që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim reciprok është juridiksion i legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës së Rrethit ku është lëshuar Polica.

Neni 7. "TABELA E PËRFITIMEVE"

(për dëmtimet shëndetësore të shkaktuara nga aksidentet në punë të punonjësve).





ALBSIG

	Përfitimi i pagueshëm në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular
A Humbja e jetës	
B Paaftësi e Përhershme	100%
1. Paaftësi e Plotë e Përhershme	100%
2. Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%
3. Humbje e plotë e përhershme e shikimit në të dy sytë	100%
4. Humbje e plotë e përhershme e shikimit në një sy	50%
5. Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy	100%
6. Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%
7. Humbje e plotë e përhershme e dëgjimit	
a. Në të dy veshët	40%
b. Në një vesh	10%
8. Humbje e plotë e të folurës	30%
9. Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës	
a. Të djathtë	40%
b. Të majtë	30%
10. Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të dorës	
a. Gishti i madh i dorës së djathtë	10%
b. Gishti i madh i dorës së majtë	8%
c. Gishti tregues, apo i mesit i dorës së djathtë	6%
A. Gishti tregues, apo i mesit i dorës së majtë	4%
B. Gishti i parafundit, ose gishti i vogël i dorës së djathtë	4%
C. Gishti i parafundit, ose gishti i vogël i dorës së majtë	2%
11. Humbje ose humbje e plotë e falangës së gishtit të dorës	1/3 e gishtit përkatës
12. Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës	
a. Të gjithë gishtërinjtë e një këmbë	10%
b. Një gisht i këmbës	3%





13. Imobilitet i plotë i përdorimit të një këmbë në nivelin e nyjes së këmbës	30%
14. Imobilitet i plotë i kofshës në nivelin e artikulacionit koksofemoral	40%
15. Imobilitet i plotë i artikulacionit të kyçit	30%
16. Dëmtimi i plotë i një veshke	30%
17. Dëmtimi i plotë i shpretkës	10%
18. Djegie e shkallës së tretë	10%

Për dëmtime shëndetësore që nuk paraqiten në këtë tabelë, shkalla e dëmtimit përcaktohet nga autoriteti mjekësor ligjor përkatës.

Zona	Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit	
Koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	20%
	e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	35%
	e barabartë ose më e madhe se 8%	75%
Trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	20%
	e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	35%
	e barabartë ose më e madhe se 20%	75%

C: Paaftësia e përkohshme	Përfitimi i pagueshëm ditor Si përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular
1. Paaftësia e përkohshme e plotë	0,025%, por jo më shumë se 2,000 Lekë
2. Paaftësia e përkohshme e pjesshme	0,010%, por jo më shumë se 1,000 Lekë

D. Përfitimi për shpenzime mjekësore — paguhet si përfitim shtesë nga Siguruesi. Përfitimi për të gjitha shpenzimet mjekësore nuk mund të jetë më lartë se 5% e shumës së siguruar.

E. Përfitimi për trajtimin mjekësor jashtë vendit — paguhet në rastet kur i Siguruari për shkak të aksidentit në punë gjatë periudhës së siguruar, ka nevojë për trajtim mjekësor të specializuar. Në këto raste i Siguruari përfiton mbulimin e shpenzimeve të mjekimit në një klinikë të specializuar jashtë vendit deri në masën 100% të shumës së sigurimit të përcaktuar në formular. Vendimi për dërgimin e të Siguruarit në një klinikë të huaj merret nga organi mjekësor kompetent, me miratimin e Siguruesit.





Neni 8. "KUSHTE TË VEÇANTA"

8.1 Shuma e sigurimit për çdo punonjës të siguruar, e përcaktuar në formularin e Policës së sigurimit, nuk mund të jetë më e ulët se 6.000.000 (gjashtë milion) Lekë. Tarifa e primit të sigurimit nuk mund të jetë më e ulët se 0.5% e shumës së siguruar të përcaktuar në formularin e Policës së sigurimit.

8.2 Përfitimi i përgjithshëm i pagueshëm për çdo të Siguar në lidhje me Paaftësinë e Plotë të Përhershme që vjen si rrjedhojë e të njëjtit dëmtim,

8.3 Përfitimi i përgjithshëm i pagueshëm për çdo të siguruar në të gjitha rastet e tjera, përveç atij të pikës 2 të këtij seksioni (VIII. Kushte të veçanta), nuk do të kalojë 100% të shumës së sigurimit dhe Siguruesi nuk do të jetë më përgjegjës sipas kësaj Police për të njëjtin të Siguar për Dëmtime Trupore Aksidentale.

8.4 Përfitimi i përgjithshëm agregat vjetor i pagueshëm nga siguruesi për të gjithë të siguruarit që përcaktohet në formularin e Policës së sigurimit, nuk mund të jetë më i ulët se katërfishi i shumës minimale të sigurimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij seksioni.

8.5 Në rastet kur i Siguruari është mëngjërash, përqindjet e përfitimeve të pikës B nga 11 deri 14 më sipër do të këmbehen duke pasur parasysh se përqindja më e lartë e përfitimit do të zbatohet për dorën e majtë dhe pjesët e saj.

8.6 Siguruesi paguan dëmshpërblimin për pasojat e drejtpërdrejta dhe të shkaktuara nga aksidenti. Në rast se në momentin e ndodhjes së aksidentit i Siguruari nuk ka qenë fizikisht i plotë dhe i shëndetshëm, janë të dëmshpërblyeshme vetëm pasojat që do të vërtetoheshin sikur aksidenti t'i kishte ndodhur një personi fizikisht të plotë dhe të shëndetshëm.

8.7 Në rast se shkaktohet humbja anatomike

ose pakësimi funksional i një organi ose gjymtyre të dëmtuar para aksidentit, përqindjet e treguara më sipër do të zvogëlohen, duke marrë parasysh shkallën e invaliditetit të mëparshëm.

8.8 Në rast se për shkak të aksidentit, vjen si pasojë pakësimi por jo humbja e plotë e përcaktuar në tabelën e përfitimeve për paaftësinë e përhershme të pjesshme, përqindjet e treguara në tabelë do të zvogëlohen në përpjesëtim me shkallën e humbjes anatomike, apo funksionale.

8.9 Përfitimi për paaftësi të përkohshme do të paguhet për jo më shumë se 12 muaj, qoftë edhe jo të vijueshme.

8.10 Siguruesi është i detyruar të paguajë dëmshpërblimin që lidhet me pikat A dhe B të tabelës së përfitimeve brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së të gjithë dokumenteve të nevojshëm nga Kontraktuesi ose i Siguruari. Përfitimet për pikën C të tabelës së përfitimeve paguhet nga Siguruesi një herë në muaj në përputhje me dokumentet vërtetues. Përfitimet sipas pikave D dhe E paguhet jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së dokumentacionit vërtetues. Çdo pagesë e përfitimit bëhet në monedhën e treguar në Policën e Sigurimit.

8.11 Në rast të zhdukjes së të siguruarit si pasojë e aksidentit në punë, Siguruesi paguan përfitimin sipas pikës A të tabelës së përfitimeve për humbjen e jetës, me kushtin që ekzistojnë prova të mjaftueshme që aksidenti ka çuar në vdekjen e të siguruarit.

8.12 Në zbatim të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij, Siguruesi Albsig sh.a. dhe personat e autorizuar prej tij, janë të autorizuar të mbledhin, përpunojnë dhe kontrollojnë të dhënat personale të të Siguarit dhe/ose Përfituesit, për qëllimet e lidhjes, administrimit dhe ekzekutimit të kontratës së sigurimit të shëndetit.





ALBSIG

Përpunimi i të dhënave personale përfshin të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe ligjore të Siguruesit, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe ruajtjes së konfidencialitetit.

Llojet e të dhënave që mund të përpunohen përfshijnë: **a)** Të dhënat e gjendjes civile: emër, mbiemër, numër personal, adresë, datëlindje, kopje të dokumentit të identifikimit; **b)** Të dhëna shëndetësore sensitive: historik mjekësor, diagnoza, rezultatet e ekzaminimeve mjekësore dhe imazherike, trajtime, receta, medikamente, fatura mjekësore dhe farmaceutike, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me gjendjen shëndetësore të të Siguruarit; **c)** Të dhëna financiare: numri i llogarisë bankare (IBAN), mandatpagesa, të dhëna transaksionesh apo pagesash lidhur me kontratën e sigurimit.

I Siguruari deklaron se është plotësisht i informuar dhe jep pëlqimin e tij për përpunimin e këtyre të dhënave sipas kushteve të përshkruara më sipër.

